



***Përpyekja për të shkuar përtej dizajnit tradicional të
mësimdhënies dhe implementimit të reformës
kurrikulare në Kosovë***

Ndryshimi i realitetit në sistemin arsimor ka sjellë kërkesa për sigurimin e praktikës efektive të mësimdhënies. Sot, detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve nuk kufizohen në mësimdhënien dhe zotërimin e mirë të një lënde (Hargreaves et al., 2010; Schratz, 2014). Fokusi është zhvendosur në zhvillimin e kompetencave të nxënësve përmes zbatimit të modeleve alternative të mësimdhënies dhe të nxënies (Fullan, 2007; Day & Gu, 2010; Van der Heijden et al., 2015; Day, 2017).

Për të kuptuar më qartë ndryshimin në rolet e mësimdhënësve, Hargreaves (2000) kishte grupuar katër faza të zhvillimit të profesionalizmit të mësimdhënësve. Në profesionalizmin aktual të mësimdhënësve – epoka pas-profesionalizmit (post-modern), përgjegjësitë e mësimdhënësve janë të shumta dhe jo të fiksuara (Day, 2017). Profesionalizmi postmodern i mësimdhënësve përfshin mësimdhënës gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues, të cilët janë të përkushtuar të punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët (Day & Gu, 2010). Midis studiuesve të ndryshëm që kanë diskutuar mbi rolet e reja të mësimdhënësve, Hargreaves (2003, f. 24) portretizon profesionalizmin e ri të mësimdhënësve duke i përshkruar ata si katalizatorë të shoqërisë së dijes dhe ilustron përgjegjësitë e tyre si në vijim:

- Stimulimi i të nxënies kognitiv
- Shfrytëzimi i mënyrave alternative të mësimdhënies
- Angazhimi për të mësuarit profesional
- Përfitimi nga mundësitë e të mësuarit nga kolegët
- Bashkëpunimi me prindërit
- Zhvillimi dhe përdorimi i inteligjencës kolektive
- Kontributi në përmirësimin e vazhdueshëm

Për më tepër, Hattie (2009, f. 238–239) ofron disa indikacione që tregojnë kompleksitetin e roleve të reja të mësimdhënësve

- Mësimdhënësit janë ndër faktorët më të rëndësishëm që promovojnë të nxënies



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

- Mësimdhënësit duhet të jenë udhëzues, me ndikim, të kujdesshëm dhe aktivisht të angazhuar në pasionin e mësimdhënies dhe të nxënit
- Mësimdhënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për atë që çdo nxënës mendon dhe di, në mënyrë që çdo nxënës të arrijë progres përmes niveleve të kurrikulës
- Mësimdhënësit duhet të dinë qëllimet e të nxënit dhe kriteret e suksesit të mësimve të tyre, të dinë se sa mirë po i arrijnë këto kritere për të gjithë nxënësit dhe të dinë se ku mund të kontribuojnë tutje drejt zhvillimit të njohurive dhe të kuptuarit aktual të nxënësve
- Udhëheqësit e shkollave dhe mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të shkollës dhe klasës ku gabimet shihen si mundësi për të mësuar, ku heqja dorë nga njohuritë dhe kuptimet e pasakta është e mirëpritur dhe ku pjesëmarrësit mund të ndihen të sigurt dhe lirshëm për të mësuar, rimësuar dhe eksploruar njohuritë dhe të kuptuarit.

Zhvillimi i një praktike efektive të mësimdhënies lidhet ngushtë me tre bazat e njohurive të mësimdhënësve (shih: Shulman, 1987), domethënë: i) njohuritë për përmbajtjen marrin parasysh rëndësinë e të kuptuarit të thellë të lëndës që do të trajtohet nga mësimdhënësi; ii) njohuritë e përgjithshme pedagogjike përfshijnë njohuritë e mësimdhënësve rreth parimeve dhe strategjive të menaxhimit të klasës (metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi, ndër të tjera); dhe iii) njohuritë mbi përmbajtjen pedagogjike përfshijnë njohuritë e mësimdhënësve për modalitetet efektive për t'ua shpjeguar lëndën nxënësve. Megjithatë, njohuritë e mësimdhënësve nuk varen vetëm nga sasia e njohurive që kanë, por edhe nga mënyra se si baza e njohurive të mësimdhënësve ndikon në marrjen e vendimeve pedagogjike për të siguruar një praktikë efektive mësimore me nxënësin në qendër (Lachner et al., 2016).

Megjithatë, në epokën e standardizimit, praktika e mësimdhënies mbështetet shumë në standardet e mësimdhënësve të përcaktuara nga jashtë që kufizojnë autonominë dhe fuqizimin e mësimdhënësve për të bërë gjykime për praktikën më të përshtatshme dhe më efektive të mësimdhënies (Hilton et al., 2013). Një problem i tillë reflekton në disa aspekte që kanë të bëjnë me profesionalizmin e mësimdhënësve, të cilat duhet të shqyrtohen në thellësi.

(i) Agjencia (fuqia për veprim) e mësimdhënësve

(ii) Identiteti i mësimdhënësve

(iii) Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve

Biesta dhe Tedder (2007) priren të përqendrohen në zhvillimin e një pikëpamjeje ekologjike të agjencisë (fuqisë për të vepruar) së mësimdhënësve. Megjithatë, agjencia kolektive, në të cilën veprimi nuk është i lidhur vetëm me qëllimin e vetëdijshëm, është paraqitur gjithashtu si aspekt



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

i rëndësishëm për të kuptuar autonominë e mësimdhënësve në kontakt të ndryshimit (Fenwick & Edwards, 2010). Analizimi i agjencisë në terma të tillë na ndihmon të kuptojmë se si mësimdhënësit janë në gjendje të jenë reflektiv dhe kreativ, duke vepruar kundër kufizimeve shoqërore, por edhe se si ata mundësohen dhe kufizohen nga mjediset e tyre shoqërore dhe materiale. Kështu, agjentët njerëzorë janë reflektiv dhe kreativ dhe mund të veprojnë në kundërshtim me kufizimet shoqërore, si dhe me mundësitë shoqërore, drejt një ndryshimi përmbajtësor në praktikën e tyre si mësimdhënës.

Ajo se kush janë mësimdhënësit si profesionist njihet ndryshe edhe si identiteti profesional i mësimdhënësve. Identiteti profesional i mësimdhënësve, sipas Kelchtermans (2009), përbëhet prej pesë pjesëve të ndërlidhura mes veti:

- Vet-imazhi: si e përshkruajnë mësimdhënësit vetveten përmes tregimeve të tyre për karrierën (imazhi se si e shohim vetveten si mësimdhënës dhe si na shohin të tjerët);
- Vetë-vlerësimi: evolucioni i vetes si mësimdhënës, sa mirë e përkufizojmë vetveten apo përkufizohemi nga të tjerët;
- Motivimi për punë: çfarë i bënë mësimdhënësit ta zgjedhin, te mbesin të përkushtuar apo ta lënë punën;
- Perceptimi për kryerjen e një pune: si e përkufizojnë mësimdhënësit punën e tyre;
- Perspektiva e së ardhmes: pritjet e mësimdhënësve për zhvillimin e ardhshëm të punës së tyre (si e shoh vetveten si mësimdhënës në të ardhmen).

Për më shumë Harjunen (2009) sugjeron këndvështrimin e identitetit të mësimdhënësit në kuadër të dimensionit pedagogjik, didaktik dhe normave e rregullave. Dimensioni i normave dhe rregullave i identitetit të mësimdhënësit janë pak a shumë ndikime të jashtme, për të cilat mësimdhënësit reflektojnë gjatë përmbushjes së rolit të tyre. Ndikimet e tilla të jashtme mund të përfshijnë kurrikulën apo politika të tjera. Hooge et al. (2011) shkojnë përtej studimeve të kaluara sa i përket identitetit profesional të mësimdhënësit duke argumentuar se përveç të qenit ekspert akademik, pedagogjik dhe didaktik mësimdhënësit ndjehen se kanë përgjegjësi për zhvillimin shoqëror si një dimension themelor i punës së tyre.

Ekzistojnë disa variabla që lidhen me zhvillimin e profesionalizmit të mësimdhënësve si dhe suksesi apo dështimin e reformave të ndryshme duke përfshirë edhe reformat kurrikulare. Shpesh, ajo që synohet në politika arsimore minimizohet apo thjeshtësohet në një ndërhyrje sipërfaqësore andaj është e nevojshme të kuptohet më në thellësi realiteti i të kuptuarit nga



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

mësimdhënësit i filozofisë së reformës kurrikulare dhe profesionalizmit të mësimdhënies, si dhe të kuptohet praktika aktuale dhe sjellja e mësimdhënësve në detyrë krahas kërkesave ndaj profesionit të mësuesisë në njërin anë dhe orientimet dhe veprimet e mësimdhënësve në kontekstin specifik në anën tjetër.

Ky hulumtim do të synojë të studjojë realitetin e punës dhe të qenit mësimdhënës në Kosovë si dhe sfidave të implementimit të reformës kurrikulare dhe reformës në profesionin e mësuesisë në Kosovë nga prizma e zhvillimeve të dy dekadave të fundit. Ky hulumtim do të jetë hulumtimi bazë i cili do të plotësohet edhe me studimin e realitetin të shkollës si organizatë dhe organizimit të sistemit të arsimit. Realiteti i zhvillimit të profesionit të mësuesisë, ndërlidhur me reformën kurrikulare, në Kosovë do të analizohet nga prizma e konceptit VUCA (Volatile, Uncertain, Complex and Ambiguous) për të kuptuar punën e mësimdhënësve në Kosovë krahas një konteksti kompleks i cili nuk do të lejojë lehtë që gjendja të vendoset në një fazë stabiliteti në rast se nuk gjendet modaliteti që tranzicioni të kalohet në një formë të mbështetur mirë, të planifikuar dhe menaxhuar mirë dhe me motivimin dhe përgatitjen e duhur të mësimdhënësve në sistem.

Pyetja kryesore që e drejton këtë hulumtim është:

Cila është rruga që duhet ndjekur profesioni i mësuesisë në Kosovë për të transformuar praktikatat aktuale të mësimdhënies?

Kjo pyetje është zbërthyer në disa nënpyetje të hulumtimit:

Si karakterizohet sjellja e mësimdhënësve të Kosovës?

Si mund të përshkruhet qasja e mësimdhënësve gjatë implementimit të mësimin në faza të ndryshme të orës mësimore?

Cilët faktor të brendshëm, organizativ dhe të profesionit formësojnë qasjen dhe veprimet e mësimdhënësve në Kosovë?

Si e kuptojnë mësimdhënësit kurrikulën e re në Kosovë dhe si e kanë përjetuar reformën kurrikulare?

Cili është profesionalizmi që kërkon reforma kurrikulare në Kosovë nga mësimdhënësit e rinj dhe cilat janë pengesat e jetësimit të saj?

Deri në çfarë niveli ekziston një të kuptuar të përbashkët për filozofinë e reformës kurrikulare në Kosovë dhe si mund të shpjegohet realiteti ekzistues?



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Si reflektojnë programet e përgatitjes së mësimdhënësve të rinj konceptet kryesore të profesionalizmit që kërkon politika kurrikulare në Kosovë?

Metodologjia

Hulumtimi do të realizohet përmes qasjes së përzier duke zbatuar instrumentet në vijim:

Anketimi me një mostër përfaqësuese të mësimdhënësve (n=400 mësimdhënës). Instrumentit përfshin këto konstrukte: sfondi personal dhe profesional; të kuptuarit e kurrikulës dhe filozofisë së saj; përvoja e mësimdhënësve në implementim të reformës kurrikulare; të kuptuarit e rolit të mësimdhënësit krahas kontekstit të punës; faktorët profesional dhe organizativ që mundësojnë e pengojnë punën e mësimdhënësve.

Vëzhgimi 70 orëve mësimore të përzgjedhur rastësisht në nivel Kosove përmes instrumentit që konstaton koha që merr mësimdhënësi në orë mësimore krahas nxënësve dhe lloji i strategjive mësimore që karakterizojnë qasjen e mësimdhënësve ndaj detyrës. Vëzhgimi poashtu konstaton edhe përqindjen e nxënësve që angazhohen gjatë orëve mësimore dhe strategjitë e mësimdhënies që dominojnë në praktikën profesionale të mësimdhënësve.

Intervistë me 70 mësimdhënësit e përzgjedhur (të njëjtit që janë vëzhguar) për të biseduar rreth realitetit të punës së tyre, bindjeve të tyre rreth filozofisë dhe kërkesave të kurrikulës së re, si dhe qasjes së tyre ndaj detyrave të punës dhe qasjes me nxënës.

Analiza e programit të edukimit në fillor për të identifikuar njohuritë, shkathtësitë dhe vlerat që adresojnë dhe niveli e forma se si i adresojnë ato krahas koncepteve që avokon reforma e re kurrikulare dhe standardet e profesionit të mësuesisë në Kosovë.

Instrumentet kualitative dhe konstruktet

- Intervista për emocionet
- Sfidat për implementimin e kurrikulave
- Përceptimet gjatë implementimit të kurrikulës
- Observimet për qasjen e mësimdhënësve në klasë

Instrumentet kuantitative dhe konstruktet

- Emocionet gjatë reformave kurrikulare - PANAS
- Konstrukt/pyetësor për 'Being a teacher - Teacher identity'.
- Perceptimi për kurrikulën - krijimi i një pyetësori



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

- Organizimi, bashkëpunimi dhe resurset shkollore - krijimi i një pyetëtori
- Pyetësor për 'Self-efficacy'
- Pyetësor për 'Burnout'

Rezultatet e pritura nga hulumtimi

Hulumtimi do të realizojë në një sërë punimesh të pavaruara por që ndërlidhen me njëri tjetrin dhe do të botohen edhe në formë të monografisë. Punimet/kapitujt që do të ndahen në kuadër të këtij hulumtimi janë:

1. Balansimi i filozofisë, shkathtësive dhe kontesktit profesional në implementim të reformës kurrikulare.
2. Mundësitë dhe kufizimet e braktisjes së paradigëmës tradicionale të mësimdhënies në Kosovë.
3. Organizimi i shkollës dhe sistemit të arsimit në funksion të zhvillimit të praktikës së re të mësimdhënies në Kosovë.
4. Përgatitja e mësimdhënësve të rinj në Kosovë në funksion të krijuesve dhe jo implementuesve të reformës kurrikulare.

Referencat

Biesta, G. J. J., & Tedder, M. (2007). Agency and learning in the lifecourse: Towards an ecological perspective. *Studies in the Education of Adults*, 39, 132–149.

Day, C. (2017). *Teachers' Worlds and Work: Understanding Complexity, Building Quality*. Routledge.

Day, C., & Gu, Q. (2010). *The new lives of teachers*. New York: Routledge.

Fenwick, T., & Edwards, R. (2010). *Actor-network theory in education*. London: Routledge.

Fullan, M. (2007). *The new meaning of educational change (4th ed.)*. New York: Teachers College, Columbia University.

Hargreaves, A. (2000). Four Ages of Professionalism and Professional Learning. *Teachers and Teaching: History and Practice*, 6(2), 151–182.

Hargreaves, A. (2003). *Teaching in the Knowledge Society. Education in the age of insecurity*. Open University Press.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Hargreaves, A., Lieberman, A., Fullan, M., & Hopkins. (2010). *Second international handbook of educational change*. Springer.

Hattie, J. (2009). *Visible learning: A synthesis of meta-analyses relating to achievement*. London: Routledge.

Hattie, J. A. C. (2012). *Visible learning for teachers: Maximizing impact on learning*. London, New York: Routledge.

Lachner, A., Jarodzka, H. & Nückles, M. (2016). What makes an expert teacher? Investigating teachers' professional vision and discourse abilities. *Instructional Science*, 44, 197–203.

Schratz, M. (2014). The European teacher: Transnational perspectives in teacher education policy and practice. *CEPS Journal*, 4(4), 11–27.

Shulman, L. (1987). Knowledge and teaching: Foundations of the new reform. *Harvard Educational Review*, 57(1), 1–23.

Van der Heijden, H.R.M.A., Geldens, J.J.M., Beijaard, D., & Popeijus, H.L. (2015). Characteristics of teachers as change agents. *Teachers and Teaching: theory and practice*, 10.1080/13540602.2015.1044328.